



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.201/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kimete Kicaj dhe Skënder Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR], paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të ndërrimit të vend votimit në Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12 tetor 2025, në seancën e panelit, të mbajtur me datë 15.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e identifikuar me numër ZL.Anr.201/2025 e datës 12.10.2025, e paraqitur nga [REDAKTUAR] paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli me seli në Prishtinë, për shkak të ndërrimit të vend votimit në Zgjedhjet Lokale 2025.

A r s y e t i m

Me datë 12.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.201/2025, paraqitur nga [REDAKTUAR] me të cilën pretendon se i është bërë ndërrimi i vendit të votimit, në një komunë tjetër, meqë rast nuk kanë pasur mundësi të votojnë.

Në përgjigjen në ankesë KQZ ka deklaruar ne pajtim me nenin 8 paragrafi 1 të LZP-së, Nr. 08/L-228, lista e votuesve i përmban të gjitha informacionet e nevojshme, ndër të tjera edhe Qendrën e Votimit në të cilën votuesi është caktuar për votim. Tutje, në përgjigje shtohet se ndërrimi i Qendrës së Votimit bazohet në përditësimet e sakta të Regjistrit Qendror Civil, andaj nëse palës ankuese i është ndryshuar QV, ka ardhur si rezultat e të dhënave të përditësuara nga Regjistri Qendror Civil. Në përgjigje kanë theksuar se KQZ vazhdimisht ka bërë fushatë informuese, përmes mediave, rrjeteve sociale dhe mesazheve telefonike për verifikimin e Qendrës së Votimit për votuesit, dhe se pala ankuese ka pasur te drejtën e ndërrimit të QV deri më datën 29.08.2025. Tutje, kane shtuar se KQZ përmes linkut qv.kqz-ks.org i ka njoftuar qytetaret përmes sms, për verifikimin e QV, si në vijim "Verifiko Qendrën tuaj të votimit. Nëse dëshironi ta ndërroni mund ta bëni deri më datë 29.08.2025." Tutje kanë

shtuar se [REDACTED] ka bërë kërkesë për ndryshim të adresës më datën 26.08.2025, në zyrat e Gjendjes Civile, e cila kërkesë është aprovuar po atë datë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga [REDACTED] për shkak të ndërrimit të vendvotimit është e pabazuar, për faktin se ankuesja ka parashtruar kërkesë për ndryshim të vendvotimit, e cila kërkesë është aprovuar nga gjendja civile po në datën e njëjtë të parashtrimit të kërkesës.

Paneli ka vlerësuar se në baze të përgjigjes së dhënë nga KQZ është vërtetuar se KQZ në vazhdimësi kanë bërë fushatë informuese përmes rrjeteve sociale dhe mesazheve telefonike për verifikim të Qendrës së Votimit për votuesit e Republikës së Kosovës, andaj kjo jep të kuptohet se parashtruesja e ankesës ka qenë në mundësi për tu informuar për ndryshim të vendvotimit ashtu siç ka kërkuar në baze të kërkesës së parashtruar për ndryshim të vendvotimit

Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se certifikimi i listës përfundimtare të votuesve është bërë më datën 06 shtator 2025, që do të thotë se Vendimi i KQZ-së për Certifikimin e Listës së Votuesve, Nr. 2350-2025 është publikuar më datën 06.09.2025, dhe kundër këtij vendimi ka pasur afat ankese 48 orë nga marrja e vendimit,

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, paneli ka gjetur se ankesa është pabazuar për faktin se konsiderohet lëshim i vet ankueses që nuk ka shfrytëzuar mundësinë që të informohet me pare për ndryshimin e vendvotimit, ashtu siç ka kërkuar në baze të kërkesës për ndryshim të Qendrës së Votimit

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin Paneli gjeti se ankesa e parashtruar është e pabazuar, dhe duke u bazuar në nenin 118 par. 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.201/2025 me datë 15.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.